

VENDIM
Nr. 146, datë 20.3.2019

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT/ PARTNERITET PUBLIK
PRIVAT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË DHE BASHKIMIT TË
OPERATORËVE EKONOMIKË “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” SHPK DHE
“BAMI” SHPK, SI KONCESIONARI DHE SHOQËRISË KONCESIONARE “KUKËS
INTERNATIONAL AIRPORT” SHPK, PËR REHABILITIMIN, OPERIMIN,
TRANSFERIMIN E AEROPORTIT
TË KUKËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit/ partneritet publik privat, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Global Technical Mechanics” sh.p.k. dhe “Bami” sh.p.k., si koncesionari dhe shoqërisë koncesionare “Kukës International Airport” sh.p.k., për rehabilitimin, operimin, transferimin e Aeroportit të Kukësit.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe